



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.142/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Gjilan, për shkak të vendosjes së posterit në shtyllë elektrike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, kështu që subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Gjilan i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2.600 (*dymijë e gjashtëqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbaramit.

A r s y e t i m

Me datën 07.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA me të cilën pretendon se me datën 07.06.2017 në qendër të qytetit të Gjilanit, aktivisti i tyre ka vërejtur se në shtyllë elektrike ishte i vendosur posteri i një kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, neni 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014, sepse vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Më datë 08.06.2017, PZAP-i pranoi kërkesë për tërheqje të ankesës me numër Anr. 121/4 të datës 07.06.2017, nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA, për tërheqjen e të gjitha ankesave të parashtruara ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje për të cilat PZAP-i nuk ka mar vendim përfundimtar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatës për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje është vendosur në shtyllë elektrike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve*

politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posterët e kandidatëve për deputet nga ky subjekt janë vendosur në objekt publik.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se është e njoftuar me rregullat zgjedhore, se shkelja nga ana e saj është e përsëritur disa herë gjatë këtij procesi zgjedhor, dhe faktin se posterit i kandidatës për deputete nga ky subjekt është vendosur në shtyllë elektrike.

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, e datës 08.06.2017, për tërheqjen e ankesës Anr.142/2017 të datës 07.06.2017, e parashtruar ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paneli vlerëson se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut dhe se në këtë rast tërheqja e njëres prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ. Në neni 54 par.1 të Ligjit për Procedurën Administratave është parashikuar që *“Tërheqja e njëres prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ në qoftë se organi kompetent i administratës publike gjykon se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut ose në interesin ligjor të palëve të tjera në procedim”*. Paneli nuk e bëri lejimin e tërheqjes së ankesës sepse ka vlerësuar se veprimi i subjektit politik LVV, ka cenuara interesin e publikut kjo aq më tepër kur kërkesës nuk iu ka shoqëruar asnjë provë në bazë të cilave do të dëshmohej se është bërë riparimi i shkeljes në teren, duke i tërhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, lidhur me nenin 51.4 të LPA-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.142/2017 më datën 09.06.2017.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.